



Влада на Република Северна Македонија  
Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në përputhje të nenit 17, nenit 17-a paragrafit 1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.38/96, 6/2002, 40/2003, 49/2006, 22/2007, 83 /2009 , 97/2010, 6/2012, 119/2013, 41/2014, 138/2014, 25/2015, 61/2015, 39/2016, 64/2018, 35/2019 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.275/2019, 89/2022 dhe 274/2022), nenit 23 dhe nenit 23-a të Statutit të NP për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" - Probishtip nr.01-351/26 datë 20.7.2022 (tekst i spastruar) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e thirrjes publike, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, formularët e paraqitjes, mënyrën e pikëzimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve dhe çështje të tjera lidhur me zbatimin e procedurës për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të bordit drejtues, përkatësisht mbikëqyrës të ndërmarrjeve publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.283/2022), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut publikon:

THIRRJE PUBLIKE nr.12/2023

për paraqitjen e personave të interesuar për emërimin e 3 (tre) anëtarëve të Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" - Probishtip

1. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të sekretarit të përgjithshëm, publikon Thirrje Publike për paraqitjen e personave të interesuar për emërimin e 3 (tre) anëtarëve të Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" - Probishtip, me mandat katër vjeçar, me të drejtë edhe për një mandat të njëpasnjëshëm.
2. Emri i Ndërmarrjes Publike: Ndërmarrja Publike për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" – Probishtip.
3. Shifra dhe veprimtaria e Ndërmarrjes Publike për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" – Probishtip sipas Klasifikimit Nacional të Veprimtarive (KNV) është:
  - 36.00- Grumbullim, përpunim dhe furnizim me ujë.
4. Kompetencat e Ndërmarrjes Publike për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" - Probishtip janë:
  - Përdorim i ujërave në bujqësi
  - Nxjerrja e zhavorrit dhe rërës
  - Prodhim i energjisë hidroelektrike
  - Grumbullim, pastrim, shpërndarje e ujit të pijshëm dhe ujit për ushqim
  - Ndërtim i objekteve hidrondërtimore
  - Projektim
  - Inxhinieri
5. Faqja e ueb-it e Ndërmarrjes Publike për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" – Probishtip: [www.hsztetovica.com.mk](http://www.hsztetovica.com.mk)
6. Për anëtar të bordit drejtues të NP për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" - Probishtip mund të emërohet personi i cili i plotëson kushtet në vijim:
  - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,

- të ketë fituar së paku 240 kredi sipas SETK ose të ketë përfunduar shkallën VII/1 të arsimit dhe
- në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës, ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- anëtarët e Bordit Drejtues duhet të kenë përvojë adekuatë të punës, edhe atë:
  - dy anëtarë të Bordit Drejtues duhet të kenë së paku pesë vjet përvojë pune në fushën e veprimtarisë së ndërmarrjeve publike (në përputhje me Klasifikimin Nacional të Veprimtarive e publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës),
  - të paktën një anëtar i Bordit Drejtues duhet të ketë së paku tre vjet përvojë pune në fushën e çështjeve financiare,
  - të paktën një anëtar i Bordit Drejtues duhet të ketë së paku tre vjet përvojë pune në fushën e çështjeve juridike dhe
  - të paktën një anëtar i Bordit Drejtues duhet të ketë së paku tre vjet përvojë pune në fushën e shkencave teknike.

7. Me fletëparaqitjen kandidatët duhet ta dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- 1) Formular për paraqitje;
  - 2) Biografi të shkurtër;
  - 3) Letër interesi/motivimi për pozitën për të cilën aplikon;
  - 4) Certifikatë të shtetësisë;
  - 5) Certifikatë ose diplomë për arsimin e lartë të përfunduar me së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose të ketë përfunduar shkallën VII/1 të arsimit, adekuatë për vendin për të cilin paraqitet;
  - 6) Vërtetim se në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës, ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
  - 7) Histori të punësimit nga Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me stazh të evidentuar;
  - 8) Deklaratë e vërtetuar në noter se kandidati me përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale vërteton për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave në fletëparaqitje dhe për dokumentacionin e parashtruar.
  - 9) Certifikata, licenca, vërtetime, diploma të lëshuara nga institucionet e autorizuara përkatësisht të akredituara për lëshimin e tyre në përputhje me ligjin për pozicionin e kërkuar.
8. Dokumentet nga pika 7 duhet të parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter dhe të njëjtat të dorëzohen në arkivin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut ose me postë në adresën: Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut bul. "Ilinden" nr.2, 1000 Shkup me shënimin: "Për Thirrjen Publike për paraqitjen e personave të interesuar për emërimin e 3 (tre) anëtarëve të Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike për Kryerjen e Veprimtarisë së Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" – Probishtip".
9. Anëtarët e Bordit Drejtues të NP për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" – Probishtip, i emëron, përkatësisht i shkarkon themeluesi i ndërmarrjes publike – Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
10. Anëtari i Bordit Drejtues të Ndërmarrjes Publike nuk mund të ketë personalisht, nëpërmjet personit të tretë ose në çfarëdo baze interesa në ndërmarrje ose në shoqërinë tregtare që është në marrëdhënie afariste me ndërmarrjen publike, të cilat mund të kenë çfarëdolloj ndikimi në pavarësinë dhe paanshmërinë e tij në vendimmarrje në ndërmarrjen publike. Secili anëtar i Bordit Drejtues është i detyruar të paralajmërojë themeluesin për ekzistimin e interesit të tillë në mesin e një ose më shumë anëtarëve të Bordit Drejtues.
11. Të papajtueshme janë funksioni kryetar dhe anëtar i Bordit Drejtues të ndërmarrjes publike me funksionet kryetar dhe anëtarë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.
12. Detyrat e punës, përgjegjësitë dhe obligimet e anëtarëve të Bordit Drejtues janë të përcaktuara në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Statutin e Ndërmarrjes Publike dhe Rregulloren e punës së Bordit Drejtues.
13. Bordi Drejtues në seancën e parë zgjedh nga radhët e tij kryetar dhe zëvendëskryetar.

14. Anëtarët e Bordit Drejtues të NP për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" – Probishtip, marrin kompensim për punën dhe anëtarësimin në Bordin Drejtues edhe atë: kryetari: 8.000,00 denarë, zëvendëskryetari 7.500,00 denarë dhe anëtari 7.000,00 denarë.
15. Afati për paraqitjen e kandidatëve të interesuar është 10 ditë pune, llogaritur nga dita e publikimit të Thirrjes Publike.
16. Thirrja do të publikohet në faqen e ueb-it të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në faqen e ueb-it të NP për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" – Probishtip, [www.hszletovica.com.mk](http://www.hszletovica.com.mk).
17. Afati i fundit për paraqitje është 25.12.2023.
18. Procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për anëtarë të Bordit Drejtues të NP për Kryerjen e Veprimtarive të Ekonomisë së Ujërave HS "Zletovica" – Probishtip do t'a zbatojë Komisioni për Burime Njerëzore dhe Zhvillim të Qëndrueshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e njëjta përbëhet nga dy faza edhe atë: Faza 1 – përzgjedhja administrative dhe Faza 2 – intervista. Për kandidatët të cilët gjatë përzgjedhjes administrative konstatohet se nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të thirrjes publike ose nuk kanë dorëzuar dëshmi të nevojshme, procedura e përzgjedhjes përfundon. Përzgjedhja administrative përfundon më së voni 15 ditë pas skadimit të afatit për paraqitjen e kandidatëve në thirrjen publike. Komisioni, më së voni dhjetë ditë nga dita e përfundimit të përzgjedhjes administrative, zbaton intervistë me kandidatët që kanë kaluar me sukses përzgjedhjen administrative. Mënyra e pikëzimit për secilën nga fazat e përzgjedhjes është përcaktuar në përputhje me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e thirrjes publike, mënyrën e parashtrimit të fletëparaqitjes, formularët e paraqitjes, mënyrën e pikëzimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve dhe çështje tjera në lidhje me zbatimin e procedurës për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të bordit drejtues, përkatësisht mbikëqyrës të ndërmarrjeve Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 283/2022).
19. Data, koha dhe vendi i saktë i mbajtjes së intervistës publikohen në faqen e ueb-it të themeluesit të Ndërmarrjes Publike.
20. Fletëparaqitja e paplotësuar dhe e pakompletuar si dhe dokumentacioni i pakompletuar dhe dokumentacioni i dorëzuar pas skadimit të afatit për aplikim nuk do të shqyrtohet.